



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 14379 Prot

Shkodër, më 20 . 8 .2019

Lënda: Mbi bllokimin e funksionimit të Bashkisë Shkodër nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

**Znj. Anila DENAJ, MINISTRE
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**

Adresa:

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr.3, Tiranë

Për dijeni: Znj. Leyla MOSES-ONES, e Ngarkuara me Punë pranë Ambasadës së SHBA në Tiranë,
Sh.T.Z. Luigi SORECA, Ambasador i Bashkimit Evropian,
Znj. Jutta GUTZKOW, Drejtuese e Zyrës së Këshillit të Europës në Tiranë
Sh.T.Z. Bernd BORCHARDT, Ambasador i Prezencës së OSBE në Tiranë;
Sh.S.Z. Peter ZINGRAF, Ambasador i Republikës Federale të Gjermanisë,
Sh.T.Z. Duncan NORMAN MBE, Ambasador i Mbretërisë së Bashkuar
Sh.T.Z. Alberto CUTILLO, Ambasador i Republikës së Italisë
Sh.T.Z. Dr. Johann SATTLER, Ambasador i Austrisë
Sh.T.Z. Adrian MAÎTRE, Ambasador i Zvicrës,

Sot më datë 20 gusht 2019, Bashkia Shkodër ka vijuar punën e saj në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”. Sot ka ndodhur një ngjarje e paprecedent në historinë e administrimit të vetëqeverisjes vendore. Ditën e sotme, Dega e Thesarit në Shkodër nuk ka pranuar të kryejë veprimet përkatëse për likuidimin e faturave për shërbimet e Bashkisë Shkodër. Po ashtu, kjo degë nuk ka pranuar as ato procedura për të cilat është e autorizuar zv.kryetarja e Bashkisë Shkodër. Me këto veprime të jashtëligjshme nuk po bllokoni Kryetaren e Bashkisë së Shkodrës, por qytetarët dhe shërbimet ndaj tyre. Ju keni bllokuar sot rikonstruksionin e rrugës Oblikë – Velinaj- Alimetaj, shërbimin e gjelbërimit, shërbimin e varrezave, shërbimet për mirëmbajtjen e stadiumit “Loro Boriçi”,

e të tjera punë në proces si projektimet dhe vijimin e investimeve me fondet e veta të Bashkisë Shkodër, pasi qeveria e ka “nxjerrë nga harta” e investimeve Shkodrën prej gjashtë vitesh.

Përmes një emaili të orës 15:02, të ditës së sotme të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit na është komunikuar se “.....sipas ligjit, Kryetares së Bashkisë i mbaron mandati me datë 20.08.2019, ora 16.30 sipas orarit zyrtar, për ditët në vijim do të jetë këshilli bashkiak që duhet të zgjidhë problemin”.

Ju bëjmë me dije se në asnjë ligj apo akt nënligjor nuk është Ministria e Financave që gjykon për mandatin e kryetarit të bashkisë apo atë çfarë bën një këshilli bashkiak. Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 60, pika 4 përcakton qartë se “Ushtrimi i mandatit të kryetarit të bashkisë fillon në çastin kur bën betimin dhe përfundon kur bën betimin kryetari pasardhës.”

Komunikimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, përmes Degës së Thesarit Shkodër është i pakuptimtë dhe në shkelje të ligjit. Nëse po përpiqeni të veproni në bazë të urdhrave politiko - partiakë, në shkelje të Kushtetutës e të ligjeve, në kundërshtim me kartën e Autonomisë Vendore, Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, duke bllokuar në aktivitetin e saj administrative dhe financiar qeverisjen vendore, konkretisht Bashkinë e Shkodrës, do të përballeni me reagimin tonë institucional dhe të qytetarëve.

Lidhur me bllokimin e paprecedent që i është bërë funksionimit të Bashkisë së Shkodrës, vëmë në dijeni Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Këshillin e Europës dhe të gjitha përfaqësitë diplomatike në vendin tonë.

Ju kërkojmë të tërhiqeni sa më shpejt nga një qëndrim i tillë, duke qenë thjesht zbatues të ligjit dhe jo të orientimeve partike - politike që dëmtojnë Shkodrën dhe qytetarët e saj.



Voltana Ademi

From: Drejtoria Financës [financa@bashkiashkoder.gov.al]
Sent: Tuesday, August 20, 2019 4:08 PM
To: emilia.koliqi@gmail.com; koliqi.emilia@bashkiashkoder.gov.al;
voltanaademi@bashkiashkoder.gov.al
Subject: FW: Mbi rregjistrimin e veprimeve ne SIFQ per Bashkine Shkoder

From: Lavdrim Sahitaj [mailto:Lavdrim.Sahitaj@financa.gov.al]
Sent: Tuesday, August 20, 2019 4:06 PM
To: Drejtoria Financës
Subject: FW: Mbi rregjistrimin e veprimeve ne SIFQ per Bashkine Shkoder

Pershendetje.

Per dijeni lidhur me problemin e ngritur nga ana juaj, meposhte pergjigja jone.

Faleminderit

Lavdrimi

From: Lavdrim Sahitaj
Sent: 20 August 2019 15:02
To: Myzafer Bushaj; Kesjana Halili
Cc: Mimoza Peco; Fran Brahimi
Subject: RE: Mbi rregjistrimin e veprimeve ne SIFQ per Bashkine Shkoder

Pershendetje Myzafer.

Lidhur per sa meposhte te kryhen veprimet e meposhtme pasi sipas Ligjit Kryetares se Bashkise I mbaron mandati me daten 20.08.2019 ora 16.30 sipas orarit zyrtare ,per ditet ne vazhdim do te jete keshilli bashkiak qe duhet ta zgjidhe problemin.

Klm

Lavdrimi

From: Myzafer Bushaj
Sent: 20 August 2019 12:21
To: Kesjana Halili
Cc: Lavdrim Sahitaj; Mimoza Peco; Fran Brahimi
Subject: Mbi rregjistrimin e veprimeve ne SIFQ per Bashkine Shkoder

Pershendetje ,

Duke ju kerkuar ndjese per shqetesimin lutemi ndihmesen Tuaj ne lidhje me rregjistrimin ose jo te veprimeve ne SIFQ per Bashkine Shkoder.

Me date 19.08.2019 eshte bere konstituimi i Keshillit Bashkiak Shkoder (mes shume peripevice dhe presioneve tashme te bera publike) . Me date 20.08.2019 mbas konstituimit te keshillit , Bashkia

Shkoder ka sjelluar pranë Degës së Thesarit TDO 3333 , disa veprime urdher shpenzime për ti rregjistruar në sistem . Po ashtu ka sjelluar për protokolle edhe shkresa të tjera që datojne me 20.08.2019.

Në këto kushte jam tej kompetencave për të kryer veprimet.

Sa më sipër lutemi ndihmesen , interpretimin dhe autorizimin Tuaj për të vazhduar ose jo më tej me veprimet e Bashkise Shkoder me firmen e Nepuneses Autorizuese ish Kryetaren e Bashkise znj. Voltana ADEMI :

1. Rregjistrimi i urdher shpenzimeve .
2. Rregjistrimi i kontratave .
3. Rregjistrimi i Urdher prokurimeve, ndryshimeve te rregjistrave etj .

Duke ju falenderuar për mirekuptimin Tuaj , jemi në pritje të udhëzimeve , interpretimeve dhe sygjërimeve në lidhje me këte çështje.

Myzafer Bushaj
Përgjegjës i Degës Thesarit Shkodër
Drejtoria e Përgjithshme e Operacioneve të Thesarit
Ministria Financave
e_mail: Myzafer.Bushaj@financa.gov.al
Mobile 0692089984

Informacioni i trasmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për institucionin të cilit i është nisur, mund të përmbajë materiale konfidenciale dhe / ose të privileguara vetëm për marrësin. Çdo rishikim, trasmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar, është i ndaluar. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të trasmetuar në kompjuterin tuaj. Ne nuk pranojmë asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkaktuar nga programe të dëmshme apo nga viruse , përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.